



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2024:121823

Datë: 13.06.2024

Numri i dokumentit: 05821279

**P.nr. 160/2024**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - Dega Viti, Departamenti i përgjithshëm**, sipas gjyqtares Blerina Jakupi Ramadani, me bashkëpunëtorin profesional Fitim Limani, duke vendosur në çështjen penale ndaj të pandehurit S.Z., me vendbanim në Viti, rruga "A.G.", numër ..., të cilin me autorizim e mbron Av. Ymer Huruglica nga Gjilani, për shkak të veprës penale Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 paragrafi 1 të KPPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.599/2024, e datës 08.05.2024, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar, me datë 23.05.2024, në mungesë të palëve me datë 24.03.2024, mori dhe shpalli publikisht, kurse me datë 13.06.2024, përpiloi me shkrim këtë:

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri **S.Z.**, nga babai N., nëna F., e lindur S., i lindur me datë ....., në ....., me vendbanim në ....., rruga "A.G.", numër ..., i martuar, babë i ... fëmijëve, ka te kryer shkollën e mesme, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal .....

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse me datën 24.04.2024, rreth orës 17.30h, nga fshati M. Republika e Maqedonisë Veriore, jashtë vendkalimit të autorizuar kufitar përmes rrugëve malore ka hy në Republikën e Kosovës, në fshatin L., duke kontrabanduar mallra, në atë mënyrë që pas ndaljes dhe kontrollit nga Njësia e Task Forcë DRK-Lindja, të veturës së markës ..... me targa ....., që po e ngiste i pandehuri S.Z., e cila veturë me drita të fikura po lëvizte nëpër rrugë malore në drejtim të fshatit M. –Rep. e Maqedonisë Veriore, gjatë kontrollit të veturës janë gjetur .... të gatshme për treg dhe ..... duhan i përpunuar i gatshëm për treg, pa dokumentacion përcjellës, ndërsa pas kontrollit në shtëpinë e tij janë gjetur dhe sekuestruar duhan i grirë me paketim i llojit ..... copë me nga ....., duhan i grirë me paketim ..... me nga ..... duhan i grirë në kuti të bardhë ....., duhan i grirë në kuti të verdhë ..... gr dhe rreth 200 kg duhan i grirë i vendosur në qese të zeza për të cilat mallra i pandehuri nuk posedonte asnjë lloj dokumentacioni, i cili është kontrabanduar nga Republika e Maqedonisë Veriore në Republikën Kosovës, me qëllim përfitimi, pa leje, pa autorizim dhe dokumentacion përkatës, kështu që i pandehuri me veprimet e tij ka kontrabanduar mallra në vlerë 6.506.90€, duke e shmang pagesën e tarifave të detyrueshme doganore në vlerë 24.188.86€, për të cilën vlerë ka dëmtuar buxhetin e Republikës së Kosovës.

- me këtë ka kryer veprën penale: kontrabandim i mallrave nga neni 311 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4,7,17,38,40,42,44,69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 242 paragrafi 6 dhe 2 dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurit S.Z., i shqipton:

## **E GJYKON**

Të pandehurit S.Z., për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi i shqipton dënim me gjobë në shumë prej 1.800.00 (njëmijë e tetëqind) euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet ta paguaj, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri i lartcekur nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj gjobën, atëherë gjykata do t'ia zëvendëson dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të barazohet me 20€ (njëzetë) euro të dënimit me gjobë.

Koha e kaluar në arrest shtëpiak prej datës 24.04.2024, deri me datë 23.05.2024, i llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë, ashtu që një ditë të qëndrimit në arrest shtëpiak do të zëvendësohet me 20.00 (njëzet) euro të dënimit me gjobë.

Koformn nenit 311 paragrafi 6 të KPRK-së, malli: ..... të llojit ..... të gatshme për treg dhe ..... duhan i përpunuar i gatshëm për treg, pa dokumentacion përcjellës, duhan i grirë me paketim i llojit ..... copë me nga ....., duhan i grirë me paketim ....., duhan i grirë në kuti të bardhë ..... copë me nga ..... duhan i grirë në kuti të verdhë ..... gr dhe rreth 200 kg. duhan i grirë i vendosur në qese të zeza, konfiskohen.

Konform nenit 311 paragrafi 7 i KPRK-së, të pandehurit S.Z., pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, i kthehet vetura e markës "M", me targa ....., çelësi i veturës dhe leja e qarkullimit të veturës, të cilat janë sekuestruar përkohsisht sipas aktvendimit për aprovim retroaktiv të sekuestrimit të përkohshëm të sendeve Ugjk 7/2024, të datës 30.04.2024.

Obligohet i pandehuri që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 20€ (njëzet) dhe 20 (njëzet) euro për viktimat e krimit konform nenit 39 paragrafi 3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave, në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të marrë formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

### **1.Rrijdha e çështjes**

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me datë 10.05.2024, në Gjykatën Themelore në Gjilan, dega në Viti ka dorëzuar aktakuzën, me numër PP.II.nr.599/2024, e datës 08.05.2024, ndaj të pandehurit S.Z., nga Vitia, rruga "A.G.", numër ..., për shkak të veprës penale Kontrabandimi i mallrave nga neni 311 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK-së).

Me datë 23.05.2024, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar dhe publik, në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Leonora Kadriu, i pandehuri S.Z., dhe mbrojtësi i të pandehurit me autorizim zëvendësues Av. Donat Huruglica. Pas leximit të aktakuzës, prokurorja e shtetit e ka bërë përmirësimin e aktakuzës në pjesën e dispozitivit të saj, tek përshkrimi i veprës penale, në rreshtin e shtatë prej fundit të faqes, duke theksuar se në vend të shprehjes 200 gram duhan i grirë, duhet të jetë 200 kilogram duhan i grirë. Gjithashtu ka sqaruar se sa i përket totalit të përgjithshëm të duhanit të kontrabanduar, nga matja në polici kanë rezultuar 525 kilogram, mirëpo nga matja në doganë kanë rezultuar 523 kilogram, andaj ka theksuar se ka kërkuar sqarim nga ana e Doganës, kurse të njëjtit i kanë konfirmuar se gjatë matjes së duhanit në Doganë është hequr pesha e paketimeve dhe është matur vetëm duhani dhe jo ambalazhi. Pas leximit dhe përmirësimit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit së shtetit, i pandehuri S.Z., ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet.

### **2.Vlerësimi i pranimi të fajësisë**

Gjykata, pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 242, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPP-së, ka marrë aktvendim me të cilin e ka aprovuar pranimin e fajësisë ndaj të pandehurit S.Z., për veprën penale si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranonte fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza edhe atë: deklaratat e të pandehurit Selajdin Zuka, fotografi nga vendi i ngjarjes, vërtetimi për sekuestrimin e përkohshëm të mallrave i datës 24.04.2024 me numër të rastit 2024-YEB-11, formulari i pranim dorëzimit të mallit i datës 25.04.2024, raporti i oficerit V.D. i datës 24.04.2024, raporti i oficerit B.N., i datës 24.04.2024, e kaluara kriminale e të pandehurit, fotografi të mallit të sekuestruar, libreza e veturës Mercedes me targa 06-542-ER, në emër të R.K., kërkesa për sekuestrimin e përkohshëm të mallit, e datës 25.04.2024, urdhëri i përkohshëm i ndalimit PP.II.nr.599/2024, i datës 26.04.2024, kërkesa për aprovim retroaktiv të kontrollit dhe sekuestrim PP.II.599/2024 i datës 26.04.2024, aktvendimi për konfirmim retroaktiv i kontrollit UGJK.nr.7/2024, i datës 30.04.2024, kërkesa për urdhër ndalues përfundimtar PP.II.599/2024, raporti i doganës për vlerësimin e mallrave, si dhe provat tjera dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

### **3.Gjendja faktike e vërtetuar**

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i pandehuri S.Z., ka kryer veprën penale: kontrabandimi i mallrave nga neni 311 paragrafi 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **4.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit**

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenin 242, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të KPP-së, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit S.Z., për veprën penale sipas dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe të njëjtit i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 1.800.00€ (njëmijë e tetëqind) euro, të cilin dënim i pandehuri obligohet ta paguaj, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Andaj, gjykata vlerëson se duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës ky dënim do të jetë i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit dhe si i tillë me këtë dënim mund të arrihen qëllimet e dënimit në kuptim të nenit 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69 dhe 70, të KPRK-së, ashtu që rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurin gjykata ka marrë faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale, gjendja e varfër ekonomike, i papunë, është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij, faktin se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh faktin se veprat e tilla janë në rritje në vendin tonë, dashjen e të pandehurit në kryerjen e veprës penale, andaj edhe mbi të lartcekurat gjykata konsideron dënimin i shqiptuar ndaj të pandehurit të lartcekur duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

### **5.Llogaritje e arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar**

Në nenin 79 paragrafi 1 të KPRK-së parashihet se “Koha e kaluar në paraburgim, arrest shtëpiak si dhe çdo periudhë e heqjes së lirisë lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim dhe me gjobë”, andaj në rastin konkret i pandehuri i lartcekur, ka qëndruar nën masën e arrestit shtëpiak edhe atë nga data 24.04.2024, deri me datë 23.05.2024, gjykata i’a llogaritë në dënimin me gjobë, në atë mënyrë që çdo 20,00 (njëzet) euro të dënimit me gjobë do të barazohen me një ditë të qëndrimit në arrest shtëpiak.

### **6.Mundësia e zëvendësimit të dënimit me gjobë me dënim me burgim**

Gjykata, duke u bazuar në nenin 43 të KPRK-së, ka vendosur që nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata do t’ia zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim do të barazohet me 20 (njëzet) euro të dënimit me gjobë.

### **7.Vendimi mbi kthimin e automjetit të konfiskuar**

Gjykata konform nenit 311 paragrafi 7 i KPPRK-së, ka vendosur që të pandehurit S.Z., pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, ti kthehet vetura e markës “Mercedes”, me targa 06-542-ER, çelësi i veturës dhe leja e qarkullimit të veturës në emër të R.L., , të cilat janë sekuestruar përkohsisht sipas aktvendimit për aprovim retroaktiv të sekuestrimit të përkohshëm të sendeve Ugjk 7/2024, të datës 30.04.2024.

**8.Vendimi për konfiskim,**

Vendimi mbi konfiskimin e sendeve është bazuar në nenin 311 paragrafi 6 të KPRK-së, ashtu që malli i sekuestruar ..... të gatshme për treg dhe ..... duhan i përpunuar i gatshëm për treg, pa dokumentacion përcjellës, duhan i grirë me paketim i llojit ....., duhan i grirë me paketim ....., duhan i grirë në kuti të bardhë ..... me nga ....., duhan i grirë në kuti të verdhë ..... duhan i grirë i vendosur në qese të zeza, e të cilat janë të ndaluara me vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të lëshuar nga Policia e Kosovës-Stacioni Policor në Kaçanik, konfiskohen. Me këtë aktgjykim do të njoftohet Dogana e Kosovës, të cilët janë të obliguar të veprojnë lidhur me mallin e konfiskuar.

**9.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale,**

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të pandehurit gjykata, duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarin ta obligojë t'i paguajë shpenzimet procedurale paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet) €, në afat prej 15 ditëve pas ditës pasuese të plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Duke u bazuar në nenin 459 parag. 5 të KPPRK-së, me këtë aktgjykim do të njoftohet Dogana e Kosovës.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura, gjykata konform nenit 364 paragrafi 1 të KPRK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – dega Viti**  
**Departamenti i përgjithshëm**  
**P.nr.160/2024, me datë 13.06.2024**

**Gjyqtarja e vetme gjyqese,**  
**Blerina Jakupi Ramadani**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.